

 Menu

HOME &gt; NEWS

## Njoftim për shtyp, datë 10 Shkurt 2022

10 February, 2022 by **KLJGJ** in **NJOFTIME PËR SHTYP**

Sot në datën 10.02.2022, Këshilli Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e tij të radhës, vendosi dërgimin e propozimit për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidates znj. Arbena Ahmeti, pranë Presidentit të Republikës për dekretim.

Përmes kësaj vendimmarrjeje, Këshilli, përmbyll me sukses procedurën e ngritjes në detyrë për kandidaten në fjalë duke mundësuar plotësimin e Gjykatës së Lartë me 10 gjyqtarë.

Plotësimi i kësaj gjykatë me 10 gjyqtarë, shënon një moment të shumëpritur duke krijuar kuorumin e nevojshëm dhe për plotësimin e Gjykatës Kushtetuese. Funkcionalizimi i plotë i këtyre dy gjykatave është jo vetëm prioritet i veprimtarisë së të gjitha institucioneve në fushën e drejtësisë por dhe një prioritet kombëtar për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian.



Këshilli i Lartë Gjyqësor mbetet i angazhuar të kontribuojë në të gjitha proceset e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit duke dëshmuar profesionalizëm dhe përgjegjshmëri maksimale. Këshilli është i përkushtuar për drejtësi të shpejtë dhe eficiente që meriton besimin e publikut!

[Previous](#)

**Njoftim për shtyp, datë 15 Shkurt 2022**

[Next](#)

**Njoftim për shtyp, datë 09 Shkurt 2022**

## Publikime



## Njoftime për shtyp



## Vende Vakante



## Kalendari i eventeve

« FEBRUARY 2022 »						
<b>M</b>	<b>T</b>	<b>W</b>	<b>T</b>	<b>F</b>	<b>S</b>	<b>S</b>
<b>31</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>6</b>
<b>7</b>	<b>8</b>	<b>9</b>	<b>10</b>	<b>11</b>	<b>12</b>	<b>13</b>
<b>14</b>	<b>15</b>	<b>16</b>	<b>17</b>	<b>18</b>	<b>19</b>	<b>20</b>
<b>21</b>	<b>22</b>	<b>23</b>	<b>24</b>	<b>25</b>	<b>26</b>	<b>27</b>
<b>28</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>6</b>

@2020 Keshilli i Lartë Gjygjësor

